



SBASHK

Sindikata e Bashkuar e Arsimit, Shkencës dhe Kultures

Arsimimi

KULTURA E NJERIUT



Ë-buletin

Nëntor, 2019

Përkushtim i jashtëzakonshëm i SBASHK në shërbim të anëtarësisë

Më shumë se 5000 mësime të pjesëmarrës në trajnime




Shqetësimet e ngritura me arsye nga mësime të Kosovës se po u mungon numri i duhur i orëve të trajnimeve për të marrë licencat e punës e për t'u përgatitur edhe për procesin e gradimeve, kanë bërë që stafi i SBASHK-ut të shtojë angazhimet që të kontribuojë edhe në këtë çështje tepër me rëndësi. Pasi ka marrë aprovimin nga Këshilli Shtetëror i Licencimit të Mësimeve për ... (faqe 4)

Me qëllim të koordinimit sa më të mirë të aktiviteteve

Takim me kryetarët e SAF e SAM te komunave të Kosovës ... (faqe 8)



Intervistë me Albina Arifin, zyrtare për informim dhe trajnime



Njeriu ndjehet krenar kur është në shërbim të arritjeve të reja të SBASHK-ut ... (faqe 3)

SBASHK në dy takime të rëndësishme ndërkombëtare

Në Asambleshën e UNESCO-s në Paris dhe të ETUCE në Varshavë



Në Paris UNESCO ka mbajtur takimet ... (faqe 7)

Sesion trajnues për perspektivën gjinore në nivelin lokal sindikal

SBASHK-u shembull i mirë për fuqizimin e rolit të gruas në sindikatë



Duke bashkëpunuar me organizatën ... (faqe 5)



Sindikata e Bashkuar e Arsimit, Shkencës dhe Kulturës
The Union of Education, Science and Culture

Editorial

Flamuri ynë në gjysmështizë



Shqiptarët kudo në Shqipëri, Kosovë e viset tjera etnike po përgatiteshin që të shpalosnin fragmente historie për nderë të ditës së madhe të flamurit, por ndjenja për festën u kthye në ndjenjë pikëllimi. Tërmetet goditën pjesë të Shqipërisë duke sjellë vdekje, ankth e dhembje. Sytë e shqiptarëve u kthyen drejt Shqipërisë. Solidaritet vëllazëror dhe dëshmi se bijtë e bijat kudo janë e duan nënën dhe gëzohen me arritjet, por edhe ndajnë dhembjen dhe gjenden pranë saj në ditë të vështira.

Dhembja shoqërohet të çdo shqiptar me krenarinë për njerëzit e thjeshtë e shpirtin e madh të tyre. Shoqërohet me krenarinë për ushtrinë e policinë e Kosovës, që me përkushtimin e angazhimin aq profesional po ndihmon kolegët e tyre atje në luftë për të shpëtuar jetë njerëzish.

Kosova është e tëra në këmbë duke shprehur solidaritetin vëllazëror e duke bërë bashkë dashurinë e dhembjen. Shqipëria nuk është vetëm në këto ditë të vështira dhe dhembja përballohet me lehtë kur e ndanë atë me vëllezërit e motrat.

Për çdo pyetje, sugjerim apo informata shtesë, mund të vizitoni ueb-faqen tonë:

www.sbashk-rks.org

Mos hezitoni të na jepni sugjerime për përfshirjen edhe të ndonji rubrike në interes të anëtarësisë në gazetën e juaj elektronike Arsimi sot.

Që SBASHK-u të jetë gjithnjë në shërbim të anëtarësisë, së shpejti do të ofroj shërbime këshillimi për ngritje profesionale për anëtarët e vet si dhe së shpejti do të paraqiten video-spote në ueb-faqen e SBASHK-ut rreth shërbimeve për anëtarësinë.

Botues: Sindikata e Bashkuar e Arsimit, Shkencës dhe Kulturës e Kosovës (SBASHK)

përfaqëson rreth 20.500 anëtarë në gjithë sektorët e arsimit në Kosovë, duke përfshirë edhe komunitetet. SBASHK është anëtare e **Edukimit Internacional (EI)** që nga viti 1996.

Email: info@sbashk-rks.org

Tel. +381(0)38/ 226 940



Intervista

Intervistë me Albina Arifin, zyrtare për informim dhe trajnime

Njeriu ndjehet krenar kur është në shërbim të arritjeve të reja të SBASHK-ut



Albina Arifi është zyrtare për informim dhe trajnime në SBASHK. Detyrat që duhet kryer për realizimin me sukses të trajnimeve nuk janë të lehta nga fakti se kërkesat për këtë aktivitet janë shtuar

shumë dhe duhet kujdes në koordinimin e saktë të trajnimeve. "Kam përkrahjen e stafit dhe organizimi është i duhur kështu që trajnimet po shkojnë mirë", thotë Albina në intervistën për gazetën tonë.

Arsimimi sot:

Kush është Albina Arifi ?

Albina:

U linda në fshatin Piranë të Prizrenit. Shkollën fillore e përfundova në vendlindje për të vazhduar shkollimin në gjimnazin "Ukshin Hoti" në Krushë të Madhe. Pas kësaj vazhdova studimet për gjuhë dhe letërsi frënge në Universitetin e Prishtinës. Aty pas kësaj vazhdova studimet për të marr titullin master i kësaj lënde.

Arsimimi sot:

Tani jeni pjesë e stafit qendror të SBASHK-ut, cilat janë detyrat tuaja konkrete këtu ?

Albina:

Tani jam e angazhuar në SBASHK në cilësinë e zyrtares për informim dhe trajnime. Pritja dhe këshillat që më janë bërë këtu më bëjnë të ndihem si në familje. Kam vërejtur se stafi këtu ka vazhdimisht gatishmëri ta ndihmojnë njëri-tjetrin kur dikush nga ne ka volem të shtuar të angazhimeve. Kjo bëhet që detyrat të kryhen mirë dhe me kohë dhe në shërbim të rrjedhës sa më të mirë të aktiviteteve të SBASHK-ut.

Arsimimi sot:

Jeni të angazhuar në njërin nga aktivitetet e SBASHK-ut , na thoni diçka më shumë për këtë.

Albina:

SBASHK-u është sindikatë e organizuar mirë dhe gëzon respekt meritor kudo në Kosovë e më gjerë sepse angazhohet dhe ka shënuar arritje të shumta në shërbim të anëtarësisë. Kam parë se ka shumë angazhime e përkushtim dhe aktivitete në SBASHK. Njëri nga to janë edhe të pesë trajnimet, që po organizohen gjatë gjithë vikendeve nëpër komunat e Kosovës për punëtorët e arsimit, gjegjësisht me anëtarët e SBASHK-ut. Ky aktivitet dukej modest në fillim , por është shtuar shumë interesimi për trajnimet dhe ne po bëjmë çmos që t'u përgjigjemi të gjitha kërkesave.

Arsimimi sot:

Cili nga pesë trajnimet duket më i vështirë për t'u realizuar?

Albina:

Trajnimi "Aplikimi i Programeve Kompjuterike në Mësimdhënie" është pak më i vështirë për t'u realizuar sepse kërkon kushte të caktuara të punës dhe atë kabinetin, lidhjen me internet dhe pas kësaj për çdo modul edhe mbahet testi i njohurive. Do theksuar se të gjitha trajnimet kanë rëndësi të veçantë, por ato katër të tjerat është më lehtë të realizohen.

Arsimimi sot:

Sa anëtarë të SBASHK-ut janë përfshirë deri tani në trajnime?

Albina:

Në komunat e Kosovës janë organizuar shumë e shumë trajnime dhe deri tani ato i kanë përfunduar me sukses 5266 anëtarë të SBASHK-ut, prej të cilëve 4866 janë certifikuar. Ky numër në çdo vikend do të shtohet. Trajnimet do të vazhdojnë deri sa të ketë kërkesa nga anëtarësia e SBASHK-ut për to.

Gjatë muajit

Përkushtim i jashtëzakonshëm i SBASHK në shërbim të anëtarësisë

Më shumë se 5000 mësimdhënës pjesëmarrës në trajnime

Shqetësimet e ngritura me arsye nga mësimdhënësit e Kosovës se po u mungon numri i duhur i orëve të trajnimeve për të marrë licencat e punës e për t'u përgatitur edhe për procesin e gradimeve, kanë bërë që stafi i SBASHK-ut të shtojë angazhimet që të kontribuojë edhe në këtë çështje tepër me rëndësi. Pasi ka marrë aprovimin nga Këshilli Shtetëror i Licencimit të Mësimdhënësve për trajnimet "Forcimi i Kapaciteteve për Udhëheqjen Efektive të Dialogut Social", "Udhëheqja dhe Planifikimi Strategjik në Arsimin Parauniversitar", "Aplikimi i Programeve Kompjuterike në Mësimdhënie", "Edukimi Medial dhe Roli i tij në Zhvillimin Shoqëror dhe Demokratik" "Mësimdhënia e Gjuhës dhe Letërsisë Shqipe për Ciklin Fillor dhe të Mesëm", ka nisur me përgatitjet bashkë me kryetarët e niveleve komunale sindikale të Arsimit Parauniversitar për të filluar me këto trajnime.




Vullneti për punë dhe përkushtimi për të qenë në shërbim të anëtarësisë kishte bërë që ky aktivitet të nis me hov, por kur kërkesat ishin shtuar shumë, u pa se me numrin e atëhershëm të trajnerëve të licencuar vështirë se do të zhvillohej ky aktivitet. Për këtë arsye SBASHK kreu me sukses edhe një aktivitet shtesë duke përgatitur trajnerë të tjerë. Një angazhim të tillë e ka përcjellë nga afër edhe Drejtori i Departamentit të Arsimit Parauniversitar në MASHT, z. Alush Istogu, i cili

është ndjerë mirë duke parë gjithë atë përkushtim e korrektësi në këtë aktivitet. Përkushtimi i jashtëzakonshëm i SBASHK-ut nëpër komunat e Kosovës ka bërë që të tejkalohen vështirësitë dhe me sukses të trajnohen deri tani 5.266 mësimdhënës.



Trajnimet kudo në komunat e Kosovës janë vizituar shpesh nga stafi i SBASHK dhe ishin këto momente, kur krahas për trajnimet, janë zhvilluar edhe bashkëbiseda për të gjitha çështjet aktuale në arsim.



Kryetari i SBASHK-ut, Rrahman Jasharaj ka shprehur respekt për përkushtimin e stafit dhe të pjesëmarrësve në trajnime duke inkurajuar edhe kryetarët e shoqatave dhe të nivelit komunal për angazhim dhe korrektësi gjatë zhvillimit të qindra trajnimeve. Po ashtu janë për t'u lavdëruar edhe trajnerët që duke dëshmuar dijen e tyre kanë bërë që trajnimet të zgjojnë kërkshërinë dhe interesimin e pjesëmarrësve për to.



Do theksuar se nga këto 5 trajnime, është ai "Aplikimi i Programeve Kompjuterike në Mësimdhënie", që po duket më i vështirë për t'u realizuar ngase kërkon kushte të veçanta për t'u zhvilluar dhe kërkon angazhime gjatë gjithë vikendeve të Ymer Ymerit, po edhe të Vjollca Shalës, që kanë për detyrë vlerësimin e arritjeve të pjesëmarrësve për secilin modul të këtij trajnimi.

Sesion trajnues për perspektivën gjinore në nivelin lokal sindikal

SBASHK-u shembull i mirë për fuqizimin e rolit të gruas në sindikatë

Duke bashkëpunuar me organizatën PEN po zhvillohen aktivitete për integrimin e perspektivës gjinore në nivelin lokal të sindikatës.



Gjatë këtij organizimi të përbashkët u diskutua në detaje rreth organizimit sindikal në Kosovë dhe rolin e gruas në këtë organizim, në mënyrë specifike në dialogun social.

Së fundmi, SBASHK ka krijuar komitetin e grave që do të shërbejë si një forum për fuqizimin e grave nga të gjitha rajonet në vendimmarrje brenda sindikatës.

Ky aktivitet kaq i gjerë është pikërisht edhe një dëshmi se SBASHK, krahas angazhimeve e arritjeve sindikale, po bën punë të madhe edhe në përpjekjet për përgatitjen sa më të mirë të mësimdhënësve dhe për ngritjen e vazhdueshme të cilësisë në arsim.



Kryetarja e sapozgjedhur e komitetit Vlora Rexhepi Berisha tregoi për rëndësinë e këtij komiteti dhe ftoi të gjitha gratë të ndajnë perspektivat e tyre dhe të ndërtojnë kapacitetet e tyre për të qenë pjesë e strukturave vendimmarrëse brenda sindikatës. Nën kryetarja e SBASHK -ut Vjollca Shala, diskutoi me të pranishmit dhe i njoftoi për ecurinë e punës në SBASHK.



Pjesëmarrëset diskutuan lidhur me rritjen e përfaqësimit e grave në nivelin lokal të federatës si dhe mundësive që u jepen grave në dialog social për çështje të punës, lejes së lehonisë dhe lejes prindërore.

Kurti u takua me përfaqësuesit e sindikatave

SBASHK me kërkesa konkrete për qeverinë e ardhshme

Kandidati për kryeministër nga VV-ja, gjegjësisht kryeministri në ardhje Albin Kurti ka organizuar në ambientet e hotelit “Grand” një takim me përfaqësues të BSPK-së, shoqatave e federatave të sindikatave të Kosovës . Qëllimi i organizatorit ishte i mirë që të dëgjohen përfaqësuesit e punëtorëve dhe të thuhet hallet e tyre, por këtë angazhim e ka zbehur paksa vënia në të njëjtin pozicion diskutimi përfaqësuesit e BSPK-së, të federatave të mëdha me ata të shoqatave sindikale.



Përfaqësues sindikal nga ndërmarrje e institucione, në të cilat janë dy e më shumë sindikata të formuara, kohën 5 minutëshe të diskutimit, në vend që të thoshin se çfarë duhet bërë për ta qeveria e re, e kanë harxhuar në kritika ndaj njëri-tjetrit . Edhe disa nga federatat që janë në kuadër të BSPK-së më shumë janë marrë me kohën e shkuar se sa që kanë kërkuar angazhime nga Kurti në mënyrë që çështjet të kenë zgjidhje në të ardhmen.



Nënkryetari i BSPK-së , Atdhe Hykolli ka ngritur disa çështje dhe është deklaruar se kjo

Konfederatë do të shtojë angazhimet dhe do të jetë këmbëngulëse në kërkesat për t'u zgjedhur drejt kërkesat e të punësuarve në Kosovë, qoftë në sektorin publik, qoftë në atë privat.

Kryetari i SBASHK-ut Rrahman Jasharaj ka kritikuar fillimisht disa shoqata e federata që po qaheshin shumë duke deklaruar se mbase është fat që VV-ja ka program social se në të kundërtën kjo që ka dëgjuar Kurti do ta trimëronte atë që të mos qante fort kokën për kërkesat dhe deklaratat e disa sindikatave. Kryetari Jasharaj pastaj është shprehur se SBASHK-u është federata më e fortë, më e organizuar dhe e dëshmuar shumë herë për angazhime, përkushtim, veprime të forta sindikale dhe për arritje. Ai pastaj ka cekur kërkesat konkrete adresuar Kryeministrit dhe Qeverisë në ardhje.



Sindikatat duhet të kenë një shtëpi të tyre dhe këtë mundësi duhet ta krijojë shteti, duhet një dialog i sinqertë nga të gjitha palët për çështjet që preokupojnë anëtarësinë , Sindikatat duhet të jenë prezente në debatet kur përgatitet Projektligji për Buxhetin dhe të dëgjohen kërkesat dhe idetë e tyre, duhet të niset me Ligjin për sigurimin shëndetësor, duhet hequr kriterin e 15 viteve për pensione kontributdhënëse në Ligjin për skemat pensionale të financuara nga shteti , Institucionet e shtetit (qendrore e lokale) mos ta përdorin një qasje bajate , sikur deri tani, që kurdo herë që nuk kanë argumente në përballje me sindikatat deklarohen në publik se kjo a ajo sindikatë është me këtë a atë subjekt politik”, ka numëruar kryetari i SBASHK çështjet në këtë takim.

SBASHK në dy takime të rëndësishme ndërkombëtare Në Asamblenë e UNESCO-s në Paris dhe të ETUCE në Varshavë



Në Paris UNESCO ka mbajtur takimet përmbyllëse për këtë vit. Pjesë e këtij aktiviteti ishte edhe Konferenca dedikuar problemeve të arsimit kudo në botë. Në këtë ngjarje të rëndësishme për arsimin ka marrë pjesë edhe përfaqësuesja e SBASHK-ut Vjollca Shala dhe kjo u bë e mundur falë përkushtimit të Internacionales Botërore të Arsimit, që emëroi si anëtare të delegacionit edhe përfaqësuesen e SBASHK-ut.



SBASHK-u ka falënderuar Internacionalen Botërore të Arsimit për nderin që i është bërë duke e përfshirë në delegacionin e saj përfaqësuesen e SBASHK-ut dhe duke i dhënë mundësi asaj të jete pjesë e kësaj ngjarje të madhe edhe përkundër faktit se Kosova, nga shkakut e pengesave që po bën Serbia, ende nuk është anëtare e Organizatës së kombeve të Bashkuara për Arsim.

Në Konferencën për Arsim ka pasur debate të shumta, që kanë pasqyruar gjendjen në arsim dhe qëllimi i kësaj Konference ishte që të shtohet

presioni ndaj ministrive të të gjitha vendeve që arsimi i lartë të jetë gjithëpërfshirës dhe i arritshëm për të gjithë pa dallim gjinie e përkatësisë kombëtare e besimit.

Në të njëjtën kur po zhvillonte punimet konferenca e UNESCO-s për arsimin, një Konferencë përmbyllëse për të bërë analizën e arritjeve dhe sfidave në arsimin e Evropës e për të vënë në theks të veçantë vlerat e përbashkëta e po ashtu edhe gjithë-përfshirjen është organizuar nga Unioni i Sindikatave të Arsimit të Evropës (ETUCE) në Varshavë. Në këtë takim të rëndësishëm kanë marrë pjesë sindikatat nga 28 shtete të Evropës e mes tyre edhe SBASHK i përfaqësuar nga Ymer Ymeri dhe Vlora Rexhepi Berisha. Përfaqësuesit e SBASHK-ut në pauzat e konferencës kanë zhvilluar takime me kolegët e tyre nga shtete të ndryshme duke këmbyer përvoja për çështje të rëndësishme të organizimit dhe veprimit sindikal.



Kryetarja e ETUCE, Christine Blouer duke nisur me punimet e takimit ka bërë një prezantim të angazhimeve, sfidave dhe arritjeve gjatë këtij viti për t'u ndalur edhe të angazhimet për vitin që vjen në shërbim të unitetit, solidaritetit dhe përkushtimit të sindikatave në shërbim të anëtarësimit dhe misionit të tyre për mbrojtjen e të drejtave të punëtorëve arsimor të Evropës.



Me qëllim të koordinimit sa më të mirë të aktiviteteve

Takim me kryetarët e SAF e SAM te komunave të Kosovës

Krahas shumë angazhimeve e detyrave ditore stafi i SBASHK-ut është në angazhime shtesë për të realizuar mirë e me përpikëri trajnimet e shumta nëpër komunitet e Kosovës. Me qëllim të koordinimit sa më të mirë të këtij aktiviteti të rëndësishëm është mbajtur takimi me kryetarët e sindikatës së Arsimit Parauniversitar nga të gjitha komunitet e Kosovës dhe Universiteti.



Në hapje të këtij takimi kryetari i SBASHK-ut ka përgëzuar stafin qendror për angazhimet në detyrat e shumta e të përditshme, duke veçuar edhe përkushtimin për mirëvajtjen e trajnimeve të shumta që po organizohen në komunitet e Kosovës. Jasharaj ka kërkuar angazhim të shtuar edhe nga kryetarët sepse, si tha ai, jemi duke u përballur me kërkesa të shumta dhe prandaj edhe duhet shtuar angazhimet në mënyrë që me kohë të krijohen kushte të duhura për mirëvajtjen e trajnimeve dhe që të bëhet ashtu si duhet koordinimi edhe me trajnerët, që do të angazhohen.



Se sa është i gjerë ky angazhim flet shifra, që deri tani të pesë trajnimet e aprovuara të SBASHK-ut nga Këshilli Shtetëror i Licencimit të Mësimdhënësve, janë përfshirë 5266 mësimdhënës, prej të cilëve tani më 4866 janë pajisur edhe me certifikata si dëshmi e kryerjes me sukses të këtyre trajnimeve. Koordinatorin për organizim të brendshëm në SBASHK, Ymer Ymeri edhe në këtë takim ka dhënë sqarime për listat e pjesëmarrësve, për detyrat konkrete të kryetarëve lidhur me organizimin e trajnimeve në komunitet e tyre dhe për çështje të tjera që lidhen me këtë aktivitet të rëndësishëm.

